

# FOLPAN 80 WDG

“Produkt për mbrojtjen e bimëve”



“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

Fungicid me veprim kontakti dhe efekt parambrojtes, me rezistence te larte ndaj shpëlarjes, partner ideal per fungicidet endoterapeutike dhe sistemike per kontrollin e shume semundjeve kerpudhore i autorizuar per perdorim ne vreshta, patate, domate dhe bimet zbukuruese.

**Lenda vepruese:** *Folpet 80 %*  
**Formulimi:** *Granula te dispergueshme ne uje (WDG)*  
**Ngjyra:** *Bezhe*

## Masat parambrojtese:

P102: Mbajeni larg fëmijëve.

P201: Merrni udhëzime të veçanta para përdorimit.

P302 + P352: Nëse bie në lëkurë: Lahuni me ujë të bollshëm.

P308 + P313: Nëse ekspozoheni ose ndjeni shqetësime: Merrni këshilla/ndihmë mjekësore.

P337 + P313: Nëse acarimi i syve vazhdon: Merrni këshilla/ndihmë mjekësore.

P362 + P364: Hiqni rrobat e kontaminuara dhe lajini para se t'i ripërdorni.

P261: Shmangni thithjen e pluhurit/tymit/gazit/mjegullës/avujve.

P280: Vishni doreza/veshje mbrojtëse/mbrojtëse për sytë/mbrojtëse për fytyrën.

P305 + P351 + P338: Nëse bie në sy: Shpëlani me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse i keni dhe janë të lehta për t'u hequr. Vazhdoni shpëlarjen.

P273: Shmangni lëshimin në mjedis.

P391: Mblidhni derdhjet e solucionit sperkates.

P501: Hidhni përmbajtjen dhe paketimin në një pikë të përshtatshme grumbullimi të mbetjeve të rrezikshme

## Udhëzime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekun:

H317: Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës.

H319: Shkakton acarim serioz të syve.

H400: Shumë toksik për jetën ujore.

H410: Shumë toksik për jetën ujore me efekte afatgjata.

EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet e përdorimit.

- Nxireni te demtuarin ne ajer te paster. Nese i demtuari ka humbur ndjenjat, shtrijeni dhe transportojeni ne pozicion anesor.
- Ne rast se eshte gellitur mos provokoni te vjella, beni lavazh te stomakut.
- Ne rast demtimi kerkoni ndihme mjekesore ne qendren spitalore me te afert dhe tregojini mjekut etiketen.
- Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi simptomatik.

## Perdorimi:

- Në hardhi, për kontrollin e vrugut (*Plasmopara viticola*), kalbezimit gri (*Botrytis cinerea*), kalbezimit të zi (*Guignardia bidwelli*), kancerit të hardhise (*Phomosis spp.*), njollosjes së kuqe të gjetheve (*Pseudopeziza*

*tracheiphila*). Përdorimi në fillim të lulezimit ndikon shumë mirë për lidhjen e frutave (pëllenimin) si dhe për një zhvillim të mirë vegjetativ.

- *Ne perime, domate (sere dhe fushe), trangull kornishon dhe luleshtrydhe* për kontrollin e vrugut (*Phytophthora infestans*), si dhe të sëmundjeve të tjera si: kalbëzimet (*Botrytis spp.*), Antraknozë (*Colletotrichum spp.*), *Septoria lycopersicum*, *Alternaria (Alternaria solani)* etj.

- *Ne pjeshke* kundër gjethepërdredhës (*Taphrina deformans*)

- *Ne Patate, për kontrollin e Fusariozës (Fusarium spp.), Alternaria solani, Antraknoza (Colletotrichum spp.),*

- *Ne trendafila* kundër Antraknozës (*Elsinoe rosarium*)

- *Ne bimët zbuturuese barishtore, palma, shkure zbuturuese, dhe bime halore apo gjetherenese që përdoren për zbuturim, kundër vrugjeve, fusariozës, Alternaries, Cadosporiosis etj.*

Në të gjitha kulturat e lartpërmendura kryhen deri 4 trajtime/sezon me interval 7-10 dite.

Doza e përdorimit: 150-200 gr preparat/100 lit ujë.

#### **Fitotoksiciteti:**

Tek rrushi i tavolinës, para se të bëhet përzierje me preparate të tjera, të verifikohet selektiviteti në bimë të kufizuara. Spërkatjet me vajra minerale nuk duhet të kryhen pa kaluar 30 ditë nga trajtimi me folpet.

#### **Ndikimi në mjedis:**

SP 1: Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Mos i pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujërave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen e sistemeve të kullimit të fermave ose rrugëve.

SPe 3: Për të mbrojtur organizmat ujorë, mbani një zonë tampon të patrajtuar prej 20 m nga ujërat sipërfaqësore.

#### **Karenca:**

10 ditë për domaten; 14 ditë për patatën, kungulloret dhe pjeshkën, 21 ditë për luleshtrydhen, 28 ditë për rrushin e tavolinës; 42 ditë për rrushin për verë; për trendafilat dhe lulet zbuturuese nuk zbatohet karenca.

#### **Vërejtje për përdorimin:**

Perzihet me të gjitha PMB-të me reaksion neutral, ndalohet perzierja me produktet që përmbajnë baker, polisulfidet dhe vajrat minerale. Mund të përdoret 20 ditë para ose pas trajtimit me vajra minerale.

**Kujdes:** Përdoren vetëm për qëllimet dhe sipas kushteve të treguara në këtë etiketë. Përdoruesi është përgjegjës për çdo dëmtim që vjen nga përdorimi i papërshtatshëm. Pajtueshmëria me të gjitha udhëzimet në këtë etiketë është thelbësore për të siguruar efektivitetin e trajtimit dhe për të shmangur dëmtimin e bimëve, njerëzve dhe kafshëve

#### **Magazini:**

Ruhet në vende të thata, në temperatura jo më të ulët se -10° C dhe jo më të lartë se 35° C.

Nr dhe data e regjistrimit: 400/1; datë 26.11.2025;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: *deri 1 kg.*

Bar kodi perkates .....

Data e prodhimit .....

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese .....

Tipi i ambalazhit baze: Material i papershkueshem nga lageshtia.

Emri dhe adresa e Aplikantit: ADAMA Agriculture BV ,Holande

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: ADAMA Makhteshim Ltd.. Izrael.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhi kryhet në Republikën e Shqipërisë): Meldi Shpk, Kavaje , Albania

